

VENDIM
Nr. 700, datë 10.10.2012

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR MASAT PËR NXITJEN E TË NXËNIT,
VIJUESHMËRISË DHE PËRPARIMIT TË NXËNËSVE ROMË DHE EGJIPTIANË TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE “NAIM FRASHËRI”, KORÇË, PËR VITIN SHKOLLOR
2012-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të 322 (treqind e njëzet e dy) bursave/kuotave ushqimore për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, për vitin shkollor 2012-2013.

2. Vlera e bursës/kuotës ushqimore ditore është 74.4 (shtatëdhjetë e katër pikë katër) lekë në ditë për nxënë, për mbulimin e kostos ushqimore. Vlera e bursës/kuotës ushqimore, që do t’u afrohet nxënësve në mjediset e shkollës në formën e shërbimit ushqimor ditor, të paketuar për çdo nxënë, jepet sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Drejtoria arsimore rajonale, Korçë, në fillim të vitit akademik duhet të dërgojë pranë njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Korçë, listën emërore të nxënësve romë dhe egjiptianë, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, të detajuar nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Një kopje e listës emërore të nxënësve të trajtuar me bursë/kuotë ushqimore dërgohet dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Fondet publike për mbulimin e shpenzimeve për bursat/kuotat ushqimore rialokohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në drejtorinë arsimore rajonale, Korçë dhe administrohen nga kjo drejtori.

5. Drejtoria arsimore rajonale, Korçë dhe drejtoria e shkollës “Naim Frashëri”, Korçë, organizojnë aktivitete ekstrakurrikulare, me qëllim nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë të shkollës “Naim Frashëri”, Korçë. Këto aktivitete organizohen në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 23.7.2010 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në programin buxhetor të arsimit 9-vjeçar.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe drejtoria arsimore rajonale, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha